

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, anëtare e trupit gjykues, kam votuar kundër vendimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Urim Buci, me arsyetimin, sa vijon:

i) Lidhur me godinë banimi 3 kat + 1 kat papafingo me sipërfaqe 318 m² dhe 150 m²shtesë

Në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar godinë banimi 3 kat + 1 kat papafingo, një pjesë e objektit është me leje ndërtimi, për sipërfaqe totale ndërtimi 318 m², ndërsa një pjesë është në proces legalizimi për sipërfaqe 150 m², duke deklaruar se kjo pasuri është 100% në pronësi të tij, me përjashtim të ndërtimit dhe mobilimit të katit të tretë të objektit (pjesa me leje ndërtimi dhe pjesa në proces legalizimi), përveç karabinasë, janë bërë nga shtetasi G.D, i cili aktualisht banon në katin e tretë të objektit 3-katësh. Burimi i krijimit: të ardhurat nga emigracioni i subjektit të rivlerësimit në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004. Vlera: 6.918.105 lekë.

Lidhur me vlerën e investuar për ndërtimin e katit të tretë të banesës në K., deklaruar në deklaratën *Vetting* si i investuar dhe poseduar nga shtetasi G.D, ky deklarim nuk mbështetet në deklarimin e subjektit në vitin 2015, ku subjekti ka deklaruar të ndërtuar gjithë banesën, por nuk deklaroi posedim apo investim nga ky shtetas, duke deklaruar vetëm se ai banon pa kundërshpërblim në banesën e tij.

Në vitin 2015 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar godinë banimi 3 kat + 1 kat papafingo, përfunduar 3 kate, të ndërtuar me të ardhurat e tij në shtetin anglez gjatë viteve 2000 – 2004.

Në të njëjtin arsyetim ndodhet subjekti dhe lidhur me vlerën e deklaruar si të investuar nga vëllai i tij në deklarimin e vitit 2005 dhe pjesën takuese të tij prej 50% në këtë ndërtesë, ky deklarim nuk gjen më pasqyrim në deklaratën *Vetting*.

Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2005, kohë kur subjekti i rivlerësimit ka marrë detyrën e oficerit të policisë gjyqësore, u deklarua banesë 2-katëshe me sipërfaqe 150 m², e pahipotekuar, në bashkëpronësi me vëllain, në vlerën 10.000.000 lekë. Burimi i krijimit: të ardhurat e vëllait gjatë emigracionit.

Për sa kohë vetë subjekti i rivlerësimit ka dhënë shpjegime të pasakta dhe kontradiktore lidhur me kohën dhe vlerën e ndërtesës, referuar vendimit nr. 11 (JR), datë 3.7.2020, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, është e pamundur të dallohet se cili deklarim është i vërtetë dhe cili ka qenë shkak që e ka detyruar subjektin e rivlerësimit për të mos respektuar kërkesat urdhëroese të ligjit për të deklaruar saktësisht dhe plotësisht burimin, kohën dhe vlerën e krijimit për këtë pasuri.

Mungesa e koherencës gjatë deklarimeve në deklaratën *Vetting*, deklarimeve periodike dhe gjatë hetimit administrativ tregon përpjekje të subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave lidhur me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie të tij, duke e vendosur atë në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 61, si dhe të nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016

ii) Lidhur me udhëtimin me automjetin e shtetasit A.C

Nga analizimi i të dhënave në sistemin TIMS rezultoi se subjekti i rivlerësimit Urim Buci ka udhëtuar në vitin 2017 me shtetasin A.C, me automjetin dhe në prezencë të këtij të fundit.

Nga hetimi i Komisionit rezultoi se subjekti ka hetuar pas këtij udhëtimi dy kallëzime penale dhe një procedim penal, ku si subjekt i kallëzuar dhe kallëzues ka qenë shtetasi A.C.

Referuar legjislationit në fuqi dhe ligjit nr. 84/2016, subjekti ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit kur ka hetuar kallëzimet penale, ku si subjekt i kallëzuar dhe kallëzues ka qenë i përfshirë shtetasi A.H.C, pasi ka udhëtuar me këtë shtetas dhe ka pasur marrëdhënie miqësie me të.

Deklarimi i subjektit në seancën dëgjimore lidhur me mungesën e kontakteve dhe dijeninë e tij mbi punësimin aktual të këtij shtetasi vijnë në kundërshtim me sa nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti në Komision gjatë hetimit administrativ nga ASHK K., ky shtetas aktualisht rezultonte drejtues i këtij institucioni.

Në referim të qëndrimeve tanimë të konsoliduara të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, subjekti i rivlerësimit, duke shqyrtuar kallëzime penale apo procedime me shtetasin me të cilin rezultoi e provuar njohja, edhe udhëtimi me automjet ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave, duke e vendosur atë në situatën e parashikuar nga neni 33, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.

iii) Lidhur me të ardhurat e përfituara nga kontrata e lidhur me Bashkinë K.

Referuar ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar, në nenin 21, pika 1 përcaktohet se: *“Asnjë individ, kur ky njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III, seksioni 2 i këtij ligji, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit dhe asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive, nuk mund të lidhë kontratë ose nënkontratë me asnjë institucion publik”.*

Me ligjin nr. 44/2014, datë 24.4.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, ‘Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike’, të ndryshuar”, hyrë në fuqi në datën 3.6.2014, çdo kontratë e lidhur me institucione publike nga data 3.6.2014 është në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, me ndryshimet përkatëse.

Në interpretim të nenit të sipërcituar, subjekti i rivlerësimit, z. Urim Buci, duke lidhur një kontratë me Bashkinë K. për dhënie me qira të ambientit të tij dhe duke përfituar të ardhura publike nga ky institucion publik, ka qenë në shkelje të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” të ndryshuar.

iv) Lidhur me denoncimin e “R. Bank”

“R. Bank” denoncoi lidhur me sa për një kontratë kredie me shoqërinë “V” sh.p.k., fillimisht marrëdhënia midis palëve ka qenë korrekte konform kushteve të kontratave, por në vitin 2017 kredimarrësi “V” sh.p.k. dhe garantuesi i kredisë nuk kanë shlyer më detyrimet kundrejt kreditorit “R. Bank”.

Në këto kushte, “R. Bank” i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për lëshimin e urdhrin të ekzekutimit për kontratën e kredisë. Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës dhe lëshimin e urdhrin të ekzekutimit.

Gjatë kryerjes së veprimeve përmbarimore, debitori ka paraqitur edhe pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin padi për “pavlefshmëri titulli ekzekutiv” ndaj kreditorit “R. Bank” dhe përmbaruesit, duke kërkuar pezullimin e veprimeve përmbarimore. Në datën 2.5.2019 gjykata ka rrëzuar kërkesën për pezullim të veprimeve përmbarimore.

Paralelisht, debitori “V” sh.p.k. ka depozituar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Kurbin një kallëzim penal për vepra penale nga “R. Bank” dhe shoqëria përmbarimore. Prokurori i ngarkuar me hetimin në lidhje me këtë kallëzim penal ka qenë subjekti i rivlerësimit Urim Buci.

Denoncuesi referon se në rastin në fjalë prokurori ka marrë vendim të paarsyetuar në kundërshtim me parimin e një procesi të rregullt ligjor, parashikuar në nenin 42 dhe 142/1 të Kushtetutës dhe në nenin 6 të KEDNJ-së.

Dërgimi pranë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të këtij procedimi penal për inspektim, të hetuar nga subjekti i rivlerësimit, do të ishte i panevojshëm, pasi ky procedim ka qenë një herë objekt shqyrtimi nga ky organ kushtetues dhe ky organ e ka vendosur një herë arkivimin e tij.

Arsyetimi ligjor është një ndër të drejtat themelore të palëve. Kjo e drejtë nuk është dhe nuk duhet të mbetet një e drejtë apo garanci deklarative, por është standard kushtetues, i garantuar dhe sanksionuar në aktet që përcaktojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si në nivel ndërkombëtar (neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut), ashtu edhe në të drejtën e brendshme (neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë).

Neni 6 i KEDNJ-së zë një vend të rëndësishëm në tërësinë e të drejtave që garanton kjo konventë. Një gjykim i drejtë në çështje penale është një element bazë i parimit të shtetit të së drejtës. Midis garancive rol kryesor zë edhe arsyetimi i vendimeve. Sipas jurisprudencës vendase, nenit 42 të Kushtetutës, arsyetimi ligjor i vendimit është një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor lidhur me të drejtën e ankimit si një e drejtë themelore e palës.

Në çështjen *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, GJEDNJ-ja doli në përfundimin se mosdhënia e një vendimi të arsyetuar në kohën e duhur nuk i dha atij kohë dhe mjete të mjaftueshme të paraqiste argumentet për t'u ankuar dhe kjo cenoi të drejtën për një gjykim të drejtë dhe moslejimin për të ushtruar në mënyrë të efektshme të drejtën e ankimit.

Mosdhënia e një vendimi të arsyetuar në kohën e duhur nga subjekti i rivlerësimit, z. Urim Buci, ka cënuar në këtë rast të drejtat ligjore të palës dhe procesin e rregullt ligjor.

Për sa më sipëraryetuar, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Urim Buci, pasi kam arritur në konkluzionin se ai ndodhet në kushtet e pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61, dhe të nenit 33, pika 5, germa "a" dhe "d" të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Xhensila PINE

Anëtare/kundër